UT	128	87	0	170	45	215
UPT	440	311	3	352	402	754
UART	29	22	0	26	25	51
UMT	54	99	5	126	32	158

² Jo të gjithë të diplomuarit e regjistruar në universitete u përfshinë në mostrat e zgjedhura të anketimit të zhvilluar në universitetet përkatëse. Janë aplikuar disa kritere për përzgjedhjen e pyetësorëve të vlefshëm nga të gjitha universitetet, përkatësisht, kërkohej që pyetësi të kishte të paktën 3 nga 6 pyetjet e zgjedhura me përgjigje, pyetjet përfshinin kualifikimin arsimor të prindërve, vlerësimin e metodave të trajnimit dhe mësimin, përvojën e studimeve jashtë vendit, përvojën e punës gjatë studimeve universitare, vlerësimin e përgjithshëm të përvojës universitare dhe synimin për të vazhduar studimet e mëtejshme.

UET	48	49	1	67	31	98
U-POLIS	107	261	5	228	145	373
UniKZKM	150	234	0	223	161	384
AU	38	17	0	41	14	55
Totali	1728	1512	33	1981	1292	3273

Krahasuar me vitin akademik 2019/20 rritja më e madhe vërehet për UPT-në që në thelb dyfishoi numrin e pyetësorëve, i ndjekur nga Universiteti Katolik dhe Universiteti Polis; për institucionet e tjera numri i të anketuarve mbetet i ngjashëm (shih Figurën 1 për më shumë detaje).

Figura 1. Numri i të anketuarve – Viti akademik: 2020/21




Figura 2. Niveli i diplomës – Viti akademik: 2020/21





Figura 2 tregon shpërndarjen e nivelit të diplomave në universitetet e marra në konsideratë gjatë këtij sondazhi. Universiteti Katolik, Universiteti POLIS, Universiteti European dhe UMT duket se kanë një prevalencë të studentëve master; të gjitha institucionet e tjera kanë një shumicë studentësh bachelor.


Figura 3. Niveli i Diplomës: Totali – Viti akademik: 2020/21



Përbërja e nivelit të diplomës për të gjithë grupin e të anketuarve nuk ka ndryshuar shumë nga viti i kaluar akademik (shih Figurën 3).

Shumica e të anketuarve ishin femra dhe një prevalencë e tillë ishte e zakonshme për të gjitha universitetet me përjashtim të UPT, ku meshkujt përbënin shumicën e të anketuarve (Figura 4).

Figura 4. Shpërndarja sipas gjinisë – Viti akademik: 2020/21



3.2 Edukimi dhe trajnimi

Pyetësi gjithashtu ofroi të dhëna në lidhje me aspekte të tilla si formimi i të diplomuarve, përvoja e mëparshme akademike si dhe aftësitë e tyre. Raporti do të fokusohet më poshtë në gjuhët e huaja dhe aftësitë teknologjike të studentëve.

3.2.1 Gjuhët e huaja

Shqipja është gjuha amtare për 96% të studentëve. 84% e tyre e konsiderojnë anglishten si gjuhë të parë të huaj, ndërsa italishtja është gjuhë e rreth 9% të studentëve nga kampioni i marrë në shqyrtim si total. Në vitin 2019, anglishtja ishte gjuha e parë e huaj për 88.24% të kampionit të marrë në studim, ndërsa italishtja ishte gjuhë e parë për vetëm 6.9% të të anketuarve. Një paraqitje grafike për këtë gjetje është dhënë në figurën 5.

Tabela 2. Gjuha e parë e huaj – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Anglisht (në %)	Italisht (në %)	Gjuhë tjetër (në %)	Nr. i të diplomuarve
AUT-UBT	88%	4%	5%	1185
UT	92%	3%	4%	215
UART	75%	14%	6%	51

UPT	92%	3%	3%	754
UMT	89%	3%	7%	158
UET	92%	4%	3%	98
U-POLIS	85%	7%	6%	373
UniKZKM	47%	45%	6%	384
AU	78%	13%	7%	55
Totali	84%	9%	1%	3273

Figura 5. Gjuha e parë e huaj – Viti akademik: 2020/21





Figura 6. Aftësitë teknologjike: Sistemet e Operimit – Viti akademik: 2020/21



3.2.2 Aftësitë teknologjike

Pyetësi mat gjithashtu njohuritë për aftësitë teknologjike së të diplomuarve në lidhje me: sistemet operative, gjuhët e programimit, word processor (përpunimin e tekstit), spreadsheets (Excel, etj.), bazat e të dhënave (Oracle, SQL server, Access, etj.), CAD/CAM /CAE - dizajnin e asistuar, shfletimin në ueb, krijimin e faqeve në internet, rrjetet e transmetimit të të dhënave, dhe multimedien (përpunimi i zërit, imazhit dhe videove).

Përsa i përket aftësive teknologjike të matura ka një ndryshueshmëri mes universiteteve, gjë që mund të shpjgohet me dallimin në profilet e tyre të ndryshme.

Njohuritë e sistemeve operative (Tabela 3) janë më të lartat tek të diplomuarit e Albanian University (75% e kampionit të marrë në shqyrtim janë përgjigjur për njohuritë e tyre si: mjaft mirë, mirë dhe shkëlqyeshëm), ndërsa aftësitë më të ulëta janë raportuar nga të diplomuarit e U-POLIS (61% e kampionit). Siç tregohet në Figurën 6, rreth 6% e të diplomuarve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje.

Tabela 3. Sistemet e Operimit – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	14%	12%	18%	34%	12%
UT	9%	10%	18%	33%	23%

UART	20%	6%	24%	27%	18%
UPT	9%	14%	16%	34%	18%
UMT	12%	8%	22%	29%	23%
UET	11%	13%	14%	36%	16%
U-POLIS	20%	13%	15%	28%	18%
UniKZKM	15%	15%	20%	30%	15%
AU	13%	9%	16%	38%	20%
Totali	13%	13%	18%	32%	16%


Siç pritej, hendeku në njohuritë e gjuhëve të programimit ndërmjet universiteteve është më i dukshëm (Tabela 4 dhe Figura 7). Universitetet që ofrojnë më shumë arsim profesional dhe teknik, si Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti i Tiranës, prodhojnë të diplomuar me njohuri më të mira të gjuhëve të programimit. Megjithatë, edhe në rastin e këtyre universiteteve, pjesa e të diplomuarve që kanë vlerësuar njohuritë e tyre të mira dhe të shkëlqyera nuk është aq e lartë (rreth 35% dhe 32%, përkatësisht), ndërsa vetëm rreth 8% e studentëve në këto universitete kanë vlerësuar njohuritë e tyre të gjuhëve të programimit si të shkëlqyera. Rreth 7% e studentëve të anketuar nuk janë përgjigjur rreth kësaj pyetje.

Tabela 4. Gjuhët e programimit – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	25%	18%	13%	27%	8%
UT	33%	18%	11%	24%	8%
UART	47%	16%	8%	18%	4%
UPT	18%	32%	14%	23%	6%
UMT	47%	25%	12%	9%	1%
UET	34%	24%	8%	19%	5%

U-POLIS	36%	25%	12%	13%	7%
UniKZKM	33%	29%	15%	15%	5%
AU	33%	22%	13%	29%	2%
Totali	28%	24%	13%	22%	6%

Figura 7. Aftësitë teknologjike: Gjuhët e programimit – Viti akademik: 2020/21



Njohuritë dhe aftësitë e përpunimit të tekstit u vlerësuan nga të diplomuarit si mjaft të mira (Tabela 5). Vetëm rreth më pak se 2% e të diplomuarve të secilit universitet treguan se nuk kanë asnjë aftësi ose aftësi të kufizuar rreth këtyre programeve. Krahasuar me universitetet e tjera, maturantët e POLIS dhe Universitetit të Tiranës i vlerësuan aftësitë e tyre më të larta. Njohuritë për përpunimin e tekstit ishin më të ulëta në mesin e të diplomuarve në Universitetin e Arteve; megjithatë, 88% e të diplomuarve i vlerësojnë njohuritë e përpunimit të tekstit si – të paktën – mjaft të mira.

Nuancat përgjithësisht të errëta të figurës 6 tregojnë se në përgjithësi studentët kanë njohuri shumë të mira rreth programeve të përpunimit të tekstit. Rreth 3% e studentëve nuk janë përgjigjur rreth kësaj pyetje.

Tabela 5. Word processor (Përpunimi i tekstit) – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	2%	1%	11%	29%	52%
UT	0%	1%	6%	17%	76%
UART	2%	4%	16%	24%	49%
UPT	0%	0%	4%	22%	70%
UMT	1%	1%	8%	17%	71%
UET	0%	0%	4%	20%	71%
U-POLIS	0%	1%	8%	18%	71%
UniKZKM	1%	3%	16%	30%	47%
AU	0%	2%	16%	18%	62%
Total	1%	1%	9%	24%	61%

Rezultatet e vlerësimit të njohurive të “spreadsheets” (Tabela 6) tregojnë se, përveç studentëve të Universitetit të Arteve të Tiranës, shumica dërrmuese e të diplomuarve demonstrojnë aftësi të mira (shiritat në Figurën 9 janë mjaft të errëta). Në rastin e UART, 20% e të anketuarve nuk përmendën asnjë aftësi ose përmendën aftësi të kufizuara në “spreadsheets”. Të diplomuarit e POLIS, Universitetit të Tiranës, Universiteti Politeknik të Tiranës dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës treguan nivele më të larta të njohurive rreth “spreadsheets”: më shumë se 93% e studentëve të çdo institucioni vlerësuan aftësitë e tyre si mjaft të mira, të mira ose të shkëlqyera. Rreth 3% e studentëve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

Figura 8. Aftësitë teknologjike: Word processor (Përpunimi i tekstit) – Viti akademik: 2020/21





Tabela 6. Spreadsheets (Excel, etj.) – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	2%	3%	14%	36%	41%
UT	1%	3%	9%	33%	53%
UART	8%	12%	20%	31%	24%
UPT	0%	3%	12%	33%	49%
UMT	3%	4%	19%	25%	46%
UET	0%	5%	8%	38%	46%
U-POLIS	1%	4%	11%	33%	49%
UniKZKM	3%	10%	21%	33%	32%
AU	2%	7%	24%	35%	29%
Totali	2%	4%	14%	34%	43%

Figura 9. Aftësitë teknologjike: Spreadsheets – Viti akademik: 2020/21




Njohuritë rreth bazave të të dhënave të të diplomuarve shqiptarë janë më të ulëta krahasuar me aftësitë e tjera të teknologjisë (Tabela 7 dhe Figura 10). Rreth 36% e studentëve të Universitetit Katolik dhe të Albanian University treguan se nuk kanë asnjë aftësi ose që kanë aftësi të kufizuara rreth bazave të të dhënave; megjithatë, më shumë se 74% e studentëve të UBT-së treguan njohuri mjaft të mira, të mira dhe të shkëlqyera. Pjesa e të anketuarve që zgjodhën të mos i përgjigjeshin kësaj pyetje përbën 8%.

Tabela 7. Bazat e të dhënave (Oracle, SQL server, Access, etc.) – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	7%	10%	16%	36%	22%
UT	7%	18%	17%	31%	22%
UART	12%	18%	20%	22%	16%
UPT	12%	17%	16%	27%	18%
UMT	16%	16%	20%	21%	20%
UET	12%	15%	17%	30%	17%


U-POLIS	10%	14%	14%	29%	25%
UniKZKM	16%	20%	20%	22%	16%
AU	16%	20%	13%	31%	15%
Totali	10%	15%	17%	30%	20%

Figura 10. Aftësitë teknologjike: Bazat e të dhënave – Viti akademik: 2020/21



Njohuritë e mjeteve të projektimit me ndihmën e kompjuterit, përkatësisht CAD (dizajn me ndihmën e kompjuterit), CAM (prodhim me ndihmën e kompjuterit) dhe CAE (inxhinieri me ndihmën e kompjuterit), janë vlerësuar si mjaft të ulëta në përgjithësi. Shumica e të diplomuarve (rreth 52%) nga të gjitha universitetet treguan mungesë totale ose njohuri të kufizuara rreth kësaj fushe (Tabela 8). Megjithatë në rastin e universitetit POLIS, 77% e 367 të diplomuarve që iu përgjigjën kësaj pyetjeje përmendën se kanë njohuri mjaft të mira, të mira ose të shkëlqyera të prodhimit/dizajnit/inxhinierisë me ndihmën e kompjuterit dhe gjithashtu edhe në Universitetin Politeknik të Tiranës, 65% e të anketuarve shprehën të njëjtin mendim.

Figura 11. Aftësitë teknologjike: CAD/CAM/CAE – Viti akademik: 2020/21




Nuancat e ngjyrave në figurën 11 nxjerrin në pah ndryshimet midis U-POLIS, UPT dhe pjesës tjetër të universiteteve: për grupin e fundit ngjyra blu është shumë e zbehtë, duke treguar kështu aspak njohuri ose njohuri të kufizuara të studentëve rreth kësaj teme.

Tabela 8. CAD/CAM/CAE – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	36%	19%	11%	19%	5%
UT	49%	26%	8%	7%	2%
UART	47%	20%	18%	4%	6%
UPT	16%	15%	16%	27%	22%
UMT	59%	22%	4%	4%	3%
UET	49%	23%	7%	9%	2%
U-POLIS	11%	10%	9%	28%	40%
UniKZKM	47%	25%	10%	11%	4%

AU	45%	29%	5%	11%	4%
Totali	33%	19%	11%	19%	12%

Figura 12. Aftësitë teknologjike: Lundrimi/Shfletimi në ueb – Viti akademik: 2020/21



Sipas shumicës dërrmuese të të diplomuarve në të gjitha universitetet, ata kanë shfaqur aftësi mjaft të mira, të mira ose të shkëlqyera përse i përket lundrimit në internet (Figura 12). Rezultatet më të këqija në këtë drejtim i kanë studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe ata të Universitetit të Arteve, përkatësisht, 6% e të anketuarve kanë treguar se nuk kanë aspak njohuri ose kanë njohuri të kufizuara përse i përket lundrimit në internet (Tabela 8); megjithatë, ky ndryshim me universitetet e tjera nuk është i madh.

Tabela 8. Lundrimi në internet – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	4%	3%	10%	24%	52%
UT	2%	2%	5%	21%	66%
UART	2%	4%	6%	18%	65%

UPT	2%	2%	5%	17%	71%
UMT	1%	1%	6%	18%	68%
UET	0%	2%	4%	15%	74%
U-POLIS	2%	2%	6%	13%	73%
UniKZKM	2%	2%	6%	24%	64%
AU	4%	0%	9%	16%	64%
Totali	3%	2%	7%	20%	63%

Sa i përket krijimit të një faqeje interneti, nuk ka shumë ndryshueshmëri mes universiteteve (Figura 13). Rreth gjysma e të diplomuarve në të gjitha universitetet që iu përgjigjën kësaj pyetjeje, deklaruan se nuk kishin aspak aftësi ose kishin aftësi të kufizuara, dhe gjysma tjetër zgjodhi kategoritë që përkojnë me aftësi mjaft të mira, të mira dhe të shkëlqyera. Përgjigjet bëjnë vetëm të diplomuarit e Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe ata të Universitetit të Tiranës, për të cilët më shumë se 35% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë aftësi të mira ose të shkëlqyera në krijimin e faqeve të internetit. Shumica e studentëve të Universitetit të Arteve dhe të UMT-së (rreth 70%) deklarojnë se nuk kanë aspak njohuri ose që kanë njohuri shumë të kufizuara në krijimin e një faqe interneti.

Figura 13. Aftësitë teknologjike: Krijimi i një faqeje interneti – Viti akademik: 2020/21

Krijimi i një faqeje interneti




Tabela 9. Krijimi i një faqeje interneti – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	23%	21%	14%	24%	10%
UT	31%	21%	11%	17%	13%
UART	47%	22%	12%	12%	2%
UPT	29%	30%	12%	15%	7%
UMT	37%	32%	8%	9%	6%
UET	28%	27%	11%	21%	7%
U-POLIS	26%	28%	18%	15%	8%
UniKZKM	32%	26%	15%	17%	6%
AU	36%	20%	15%	24%	2%
Totali	28%	25%	14%	19%	8%

Aftësitë në rrjetet e transmetimit të të dhënave janë përgjithësisht shumë të kufizuara për studentët e marrë në konsideratë gjatë anketimit (Figura14). Njohuritë për rrjetet e transmetimit të të dhënave ishin më të larta midis të diplomuarve të Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku rreth


gjysma e studentëve i kanë vlerësuar njohuritë e fituara nga mjaft të mira deri në të shkëlqyera (Tabela 10). Më shumë se 60% e të diplomuarve nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë nuk kanë njohuri ose kanë njohuri të kufizuara mbi rrjetet e transmetimit të të dhënave.

Tabela 10. Rrjetet e transmetimit të të dhënave – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	23%	18%	15%	26%	9%
UT	25%	24%	16%	18%	9%
UART	39%	20%	16%	18%	2%
UPT	25%	26%	16%	16%	8%
UMT	34%	28%	10%	15%	4%
UET	27%	26%	12%	18%	10%
U-POLIS	32%	23%	14%	16%	10%
UniKZKM	28%	25%	17%	17%	8%
AU	36%	24%	15%	15%	5%
Totali	26%	22%	15%	20%	9%

Figura 14. Aftësitë teknologjike: Rrjetet e transmetimit të të dhënave – Viti akademik: 2020/21

Rrjetet e transmetimit të të dhënave




Njohuritë rreth mjeteve multimediale nuk ndryshojnë ndërmjet universiteteve (Tabela 11). Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve në anketë në të gjitha universitetet kanë njohuri mjaft të mira, të mira ose të shkëlqyera rreth mjeteve multimediale.

Tabela 11. Multimedia (përpunimi i zërit, imazhit dhe videos)– Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë	Të kufizuara	Mjaft mirë	Mirë	Shkëlqyeshëm
AUT-UBT	15%	17%	17%	28%	17%
UT	12%	24%	22%	22%	15%
UART	12%	24%	22%	24%	14%
UPT	11%	22%	20%	28%	14%
UMT	14%	22%	18%	25%	15%
UET	13%	29%	20%	19%	13%
U-POLIS	11%	20%	17%	28%	22%
UniKZKM	12%	18%	23%	27%	17%

AU	24%	22%	11%	33%	9%
Totali	13%	20%	19%	27%	16%

Figura 15. Aftësitë teknologjike: Multimedia (përpunimi i zërit, imazhit dhe videos)- Viti akademik: 2020/21



Megjithatë, të diplomuarit e POLIS i kanë vlerësuar njohuritë e tyre për mjetet multimediale mesatarisht më të larta se ato të universiteteve të tjera: rreth 50% e të anketuarve raportuan aftësi të mira dhe të shkëlqyera.

Ndërkohë, 30% e studentëve të Universitetit Katolik kanë deklaruar se nuk kanë njohuri ose kanë njohuri të kufizuara rreth mjeteve multimediale (Figura 15).

Në përgjithësi, në vitin akademik 2019/20, të diplomuarit kanë shfaqur aftësi të mira në përpunimin e tekstit, “spreadsheets” dhe në lundrimin në ueb dhe nga ana tjetër kanë shfaqur më pak aftësi në prodhim, dizajn dhe inxhinieri të realizuara me ndihmën e kompjuterit. Dallimet e mëdha pasqyrojnë shkallën e ndryshimit midis praktikës profesionale dhe teknike të secilit universitet.

3.3 Informacion mbi degën e studimit

Pyetësi mblodhi të dhëna për aspekte të ndryshme të degës ku kishin studiuar të diplomuarit, duke përfshirë pyetje rreth materialeve të ofruara mësimore, organizimin e përgjithshëm të provimeve, metodat e përdorura për trajnimin dhe të mësuarin, ngarkesën dhe përvojën e punës gjatë studimeve. Për të identifikuar motivet që ishin më të rëndësishme kur vendoset për t'u regjistruar në një universitet, janë paraqitur dhe vlerësuar dy arsye të mundshme:

3. Interesimi për vetë përmbajtjen që ofron dega
4. Interesimi për mundësitë e punësimit që ofron dega

në një shkallë me katër nivele: "Jo, sigurisht", "Më shumë jo se po", "Më shumë po se jo" dhe "Po, sigurisht".

Për motivin 1, më shumë se 80% e studentëve të anketuar pohuan se interesi për përmbajtjen e degës të zgjedhur ishte padyshim një arsye e rëndësishme kur vendosën të regjistroheshin dhe në përgjithësi, vetëm një përqindje e papërfillshme (më pak se 5%) deklaruan se nuk ishin të interesuar për përmbajtjen që ofron dega e studimit kur vendosën për të (shih Tabelën 12).

Rezultate të ngjashme dolën në pah edhe për motivin 2, pasi më shumë se 80% e studentëve të anketuar pohuan se interesi për mundësitë e punësimit që ofron dega e studimit ishte padyshim një arsye e rëndësishme kur vendosën të regjistroheshin në degën që kanë zgjedhur (Tabela 13). Diferenca të vogla u vunë re kur në shqyrtim merreshin universitete të ndryshme të përzgjedhura. Për shembull, nuk kishte student të Universitetit të Arteve që nuk ka pasur interes për lëndët kur ka vendosur të regjistrohet (vetëm përgjigje pozitive); megjithatë, rreth 8% e këtij grupi studentësh nuk besonin shumë në mundësitë e punësimit pas përfundimit të universitetit (kjo është një përqindje më e lartë, në krahasim me universitetet e tjera).

Tabela 12. Rëndësia e arsyes: interesi për përmbajtjen që ofron dega – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Jo, sigurisht	Më shumë jo sesa po	Më shumë po sesa jo	Po, sigurisht
AUT-UBT	0,68%	3,80%	16,12%	79,24%
UT	0,93%	3,26%	15,81%	79,53%
UART	0,00%	0,00%	15,69%	84,31%
UPT	0,40%	3,98%	19,10%	76,13%
UMT	0,00%	4,43%	8,23%	87,34%

UET	2,04%	4,08%	13,27%	79,59%
U-POLIS	0,54%	1,61%	10,72%	86,06%
UniKZKM	0,26%	0,78%	8,59%	90,36%
AU	0,00%	1,82%	7,27%	90,91%
Totali	0,55%	3,15%	14,67%	81,48%

Figura 16. Motivi: interesi për përmbajtjen që ofron dega – Viti akademik: 2020/21





Tabela 13. Rëndësia e arsyes: Interesimi për mundësitë e punësimit që ofron dega (mundësitë e punësimit) – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Jo, sigurisht	Më shumë jo sesa po	Më shumë po sesa jo	Po, sigurisht
AUT-UBT	0,68%	4,22%	16,03%	78,31%
UT	0,93%	5,58%	11,63%	81,86%

UART	3,92%	3,92%	21,57%	70,59%
UPT	0,13%	2,52%	13,53%	83,29%
UMT	0,63%	1,27%	16,46%	81,65%
UET	1,02%	3,06%	13,27%	82,65%
U-POLIS	0,00%	3,49%	18,23%	77,75%
UniKZKM	0,00%	1,30%	12,50%	85,94%
AU	0,00%	0,00%	14,55%	85,45%
Totali	0,46%	3,24%	15,03%	80,97%

Figura 17. Motivi: Interesimi për mundësitë e punësimit që ofron dega – Viti akademik: 2020/21



Të diplomuarit janë pyetur gjatë anketimit edhe nëse kanë kryer ndonjë aktivitet pune gjatë ndjekjes së studimeve. Sipas rezultateve të ilustruara në tabelën 14, më shumë se gjysma e studentëve treguan se kanë punuar me kohë të plotë, me kohë të pjeshme ose herë pas here gjatë studimeve të tyre dhe vetëm 21% nuk kanë punuar kurrë gjatë studimeve universitare (në maj 2019/20 rezultati ishte 37%) . Universiteti POLIS dhe UET kanë pjesën më të madhe (rreth 35%) të studentëve që nuk kanë punuar, qoftë edhe herë pas here.

Tabela 14. A keni kryer ndonjë aktivitet pune gjatë studimeve universitare? – 2020/21

Universiteti	Jo	Po, ishte një aktivitet pune i rastësishëm, i parregullt ose sezonal	Po, një punë e vazhdueshme me kohë të pjesshme	Po, një punë e vazhdueshme me kohë të plotë	Numri i të diplomuarve
AUT-UBT	23%	32%	9%	35%	1185
UT	24%	24%	14%	38%	215
UART	16%	39%	18%	25%	51
UPT	17%	26%	20%	36%	754
UMT	9%	25%	23%	43%	158
UET	34%	23%	10%	33%	98
U-POLIS	36%	30%	9%	23%	373
UniKZKM	10%	17%	18%	55%	384
AU	29%	13%	15%	40%	55
Totali	21%	27%	14%	37%	3273

Studentët u pyeten gjithashtu nëse ata punonin në kohën kur po anketoheshin dhe statusi i tyre është paraqitur në Figurën 18. 42% e studentëve të anketuar punonin; 57% e të anketuarve të Universitetit POLIS punonin ndërkohë që plotësonin përgjigjet e këtij pyetësi.

Nga ata studentë që punonin në momentin e diplomimit të tyre, shumica (61%) kishin kryer një aktivitet pune pjesërisht ose plotësisht në përputhje me studimet universitare (shih tabelën 15), ndërkohë pjesa tjetër punonte në një aktivitet që nuk lidhej me studimet e tyre, që do të thotë se ndoshta gjysma e tyre kanë punuar për të mbuluar shpenzimet e tyre gjatë periudhës së studimeve. Përqindja ishte më e ulët për vitin akademik 2019/20, respektivisht 52%.

Figura 18. A po punoni ju aktualisht? – Viti akademik: 2020/21




Tabela 15. A është aktiviteti juaj aktual i punës i lidhur me studimet universitare që keni kryer? – Viti akademik: 2020/21


Universiteti	Jo	Po, por vetëm për një pjesë të tij	Po	Nr. i të diplomuarve që punojnë
AUT-UBT	48%	16%	35%	613
UT	42%	14%	43%	90
UART	44%	11%	44%	18
UPT	33%	22%	44%	254
UMT	36%	12%	52%	42
UET	34%	26%	39%	38
U-POLIS	12%	21%	66%	211
UniKZKM	34%	20%	44%	97
AU	47%	32%	21%	19
Totali	38%	18%	43%	1370

Vetëm 5% e studentëve kishin përvojë studimi jashtë vendit (shih Tabelën 16). Përqindjet më të mëdha vihen re në Universitetin e Arteve dhe Universitetin Evropian (rreth 15%).

Tabela 16. A keni studiuar jashtë vendit gjatë studimeve tuaja aktuale universitare? – Viti akademik: 20/21

Universiti	Jo	Po	Nr. i të diplomuarve
AUT-UBT	95%	5%	1185
UT	96%	3%	215
UART	86%	14%	51
UPT	95%	3%	754
UMT	96%	3%	158
UET	83%	15%	98
U-POLIS	92%	7%	373
UniKZKM	90%	8%	384
AU	95%	4%	55
Totali	94%	5%	3273

Figura 19. A keni studiuar jashtë vendit gjatë studimeve universitare? – Viti akademik: 2020/21



3.4 Vlerësimi i degës së studimit

Studentëve iu kërkua të vlerësonin kënaqësinë e tyre në lidhje me marrëdhëniet që kishin krijuar me aktorë të ndryshëm në universitet. Në vitin 2020/21, siç tregohet në tabelën 17, përqindjet e të diplomuarve shumë të kënaqur me marrëdhënien që kishin me stafin akademik varionin nga 25% (UMT) në 77% (UniKZKM), me rreth 52% në përgjithësi. Figura 20 paraqet grafikisht shpërndarjen e shkallës së kënaqësisë për çdo universitet.

Tabela 17. Niveli i kënaqësisë në lidhje me marrëdhëniet me mësuesit në përgjithësi – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Jo, sigurisht	Më shumë jo sesa po	Më shumë po sesa jo	Po, sigurisht
AUT-UBT	1%	5%	34%	59%
UT	2%	11%	43%	39%
UART	0%	6%	37%	51%
UPT	0%	14%	52%	29%
UMT	3%	20%	48%	25%
UET	1%	2%	31%	61%

U-POLIS	0%	2%	28%	68%
UniKZKM	1%	1%	21%	77%
AU	0%	2%	25%	69%
Totali	1%	7%	37%	52%

Gjatë anketimit janë marrë shumë reagime pozitive në lidhje me kënaqësinë e përgjithshme të studentëve për degën e studimit. Bazuar në përgjigjet e të diplomuarve mund të thuhet se në vitin 2019 shumica e studentëve ishin në përgjithësi të kënaqur me degën e studimit: pjesa më e vogël e të diplomuarve të kënaqur i përket UMT (73%), ndërsa më e madhja i përket AU (96%). UniKZKM rezultoi se kishte përqindjen më të madhe të studentëve definitivisht të kënaqur, me 78%. Vetëm një përqindje e vogël e të diplomuarve në të gjitha universitetet u përgjigjën se ata nuk janë aspak të kënaqur me degën e studimit (shih Tabelën 18).

Figura 21 paraqet të gjitha përgjigjet.

Figure 20. A jeni ju të kënaqur me pedagogët në përgjithësi? – Viti akademik: 2020/21





Tabela 18. A jeni në përgjithësi i kënaqur me degën tuaj të studimit? – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Jo, sigurisht	Më shumë jo sesa po	Më shumë po sesa jo	Po, sigurisht
AUT-UBT	1%	5%	31%	61%
UT	1%	8%	46%	41%
UART	2%	8%	39%	45%
UPT	1%	14%	48%	33%
UMT	3%	17%	47%	29%
UET	1%	3%	30%	61%
U-POLIS	0%	4%	27%	66%
UniKZKM	1%	1%	21%	78%
AU	0%	0%	31%	65%
Totali	1%	7%	35%	54%

Figura 21. A jeni në përgjithësi i kënaqur me degën tuaj të studimit? - Viti akademik: 2020/21



Së fundi, të anketuarit u pyetën nëse do të regjistroheshin sërish në universitet. Për këtë pyetje u vunë në dispozicion katër opsione:

6. Jo, nuk do të regjistrohesha më në universitet
7. Po, por në një degë tjetër dhe në një universitet tjetër
8. Po, në të njëjtin degë, por në një universitet tjetër
9. Po, por në një degë tjetër të këtij universiteti
10. Po, në të njëjtën degë të këtij universiteti


Rezultatet janë paraqitur në Figurën 22. Përqindjet e detajuara janë raportuar në Tabelën 19.

Në përgjithësi, shumica do të regjistroheshin sërish në të njëjtën degë të të njëjtit universitet (rreth 70%); Natyrisht, ka edhe disa ndryshueshmëri midis universiteteve. Kënaqshmëria më e madhe vërehet për UniKZKM (me 89% për opsionin 5), ndërsa më e ulëta për UMT (me respektivisht 56%). Vetëm 3% e studentëve treguan se nuk do të regjistroheshin më në universitet.

Tabela 19. Nëse do të mund të ktheheshit pas në kohë, a do të regjistroheshit sërish në universitet?– 20/21

Universiteti	Jo, nuk do të regjistrohesha më në universitet	Po, por në një degë tjetër dhe në një universitet tjetër.	Po, në të njëjtin degë, por në një universitet tjetër	Po, por në një degë tjetër të këtij universiteti	Po, në të njëjtin degë të këtij universiteti
AUT-UBT	4%	5%	4%	17%	69%
UT	2%	8%	13%	9%	61%
UART	6%	6%	6%	10%	65%
UPT	3%	6%	12%	12%	63%
UMT	3%	6%	16%	15%	56%
UET	3%	5%	6%	7%	73%
U-POLIS	2%	2%	5%	13%	75%
UniKZKM	2%	1%	5%	4%	89%
AU	0%	4%	5%	16%	71%
Totali	3%	5%	7%	13%	70%

Figura 22. Nëse do të mund të ktheheshit pas në kohë, a do të regjistroheshit sërish në universitet? – 20/21




3.5 Informacion rreth familjes

Dihet gjerësisht se performancat akademike varen nga shumë variabla që kanë të bëjnë me sfondin social të studentit, duke përfshirë përvojën e mëparshme akademike, nivelin arsimor të prindërve, etj. Prandaj, është konsideruar e rëndësishme të merren parasysh këta faktorë gjatë vlerësimit të rezultateve akademike.

Figura 23 përshkruan shpërndarjen e formimit të përgjithshëm arsimor të prindërve të të diplomuarëve, duke bërë dallimin midis baballarëve dhe nënave. Siç mund të shihet, nuk ka shumë dallime për të dy gjinitë: shpërndarjet duken shumë të ngjashme.

Figura 23. Sfondi arsimor i prindërve – Viti akademik: 2020/21

Sfondi arsimor i prindërve



Tabelat 20 dhe 21 tregojnë shpërndarjen e formimit arsimor të prindërve për universitetet e marra në konsideratë gjatë këtij studimi. Pjesa më e madhe e të diplomuarve, prindërit e të cilëve kanë një diplomë akademike vërehet se bëjnë pjesë në universitetin POLIS dhe UniKZM (respektivisht 43% dhe 48%). Shumica dërmuese (mbi 75%) e studentëve të të gjitha universiteteve kanë prindër me të paktën një certifikatë përfundimi të shkollës së mesme.

Tabela 20. Sfondi arsimor i baballarëve – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë kualifikim	Certifikate e ciklit të ulët	Certifikatë e arsimit bazë	Certifikate e përfundimit të shkollës së mesme	Diplomë universitare
AUT-UBT	4%	2%	14%	58%	19%
UT	1%	2%	15%	50%	27%
UART	2%	0%	27%	45%	18%
UPT	2%	1%	14%	50%	24%
UMT	3%	1%	10%	48%	32%

UET	0%	3%	10%	44%	33%
U-POLIS	1%	1%	4%	43%	43%
UniKZKM	1%	1%	8%	40%	48%
AU	0%	0%	16%	45%	31%
Totali	2%	1%	12%	50%	28%

Tabela 21. Sfondi arsimor i nënave – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Asnjë kualifikim	Certifikatë e ciklit të ulët	Certifikatë e arsimit bazë	Certifikatë e përfundimit të shkollës së mesme	Diplomë universitare
AUT-UBT	3%	1%	18%	56%	17%
UT	1%	1%	24%	46%	23%
UART	4%	0%	22%	41%	25%
UPT	2%	1%	18%	45%	25%
UMT	2%	1%	17%	42%	32%
UET	0%	1%	9%	45%	36%
U-POLIS	1%	1%	5%	42%	45%
UniKZKM	1%	1%	9%	39%	48%
AU	2%	0%	20%	47%	24%
Totali	2%	1%	16%	48%	28%


3.6 Synimet dhe perspektivat e së ardhmes

Në vitin 2020/21, shumica dërrmuese e të diplomuarve të mostrës së marrë në studim treguan synimin e tyre për të vazhduar studimet. Megjithatë, kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se shumica e kampionit ishin studentë Bachelor. Përjashtim bëjnë vetëm të diplomuarit në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe të diplomuarit në POLIS, 36% e të cilëve u shprehën se nuk dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

Tabela 22. Dëshironi të vazhdoni studimet? – Viti akademik: 2020/21

Universiteti	Jo	Po
AUT-UBT	36%	61%
UT	16%	76%
UART	16%	73%
UPT	19%	70%
UMT	8%	81%
UET	16%	72%
U-POLIS	36%	60%
UniKZKM	15%	85%
AU	13%	80%
Totali	26%	69%

Figura 24. Synimi për të vazhduar studimet – Viti akademik: 2020/21



IV. Konkluzione

Ky pyetësor iu dorëzua të diplomuarve të nëntë Universiteteve partnere shqiptare të regjistruar në platformën GRADUA në 2020/21 me synimin për të analizuar ecurinë e karrierës dhe kënaqësinë e studentëve ndaj aspekteve të ndryshme të përvojës së tyre të studimit. Gjithsej 3273 të diplomuar iu përgjigjën plotësisht pyetësorit. Në total 53% e numrit të të anketuarve ishin studentë bachelor, 46% studentë master dhe vetëm 1% ishin nga programe doktorature ose specializimi. Shumica e të anketuarve ishin femra (60.5%).

Pjesa e parë e pyetësorit iu kushtua arsimimit dhe aftësive të të diplomuarve.

94% e studentëve treguan se dinë të paktën një gjuhë të huaj. Në të gjitha universitetet gjuha e huaj dominuese ishte anglishtja, përveç UniKZKM ku një përqindje e madhe e studentëve flisnin italisht. Në përgjithësi, italishtja është gjuha e dytë e huaj e shumicës së të anketuarve.

Studentët gjithashtu treguan aftësi të mira teknologjike në disa aspekte (sistemet operative, programimi, “spreadsheets” dhe “Word”, shfletimi dhe krijimi i faqeve në internet, multimedia...) pa dallime të mëdha midis universiteteve. Njohuri më të dobta ata shfaqën kryesisht në CAD/CAM/CAE, me përjashtim të disa universiteteve që i kushtojnë më shumë rëndësi praktikës profesionale.

Për sa i përket eksperiencave të studimit, shumica e studentëve (78%) kishin përvojë pune, të paktën rastësore ose sezonale. Jo gjithmonë pozicionet e tyre ishin të lidhura me studimet universitare të kryera, duke treguar kështu se zgjedhja e punës ishte për nevoja të domosdoshme dhe mund të ndikonte në karrierë.

Pyetësori i kushtëoi rëndësi edhe matjes së kënaqësisë ndaj aspekteve të ndryshme të përvojës së studimit. Në përgjithësi, kënaqësia ndaj degës të studimit dhe pedagogëve ishte shumë e lartë në të gjitha universitetet.

Për sa i përket faktorëve të mundshëm që ndikojnë në rezultatet akademike, u mor në konsideratë edhe formimi arsimor familjar. Në këtë aspekt kishte dallime të rëndësishme ndërmjet universiteteve. Në U-Polis dhe AU përqindja e nënave ose baballarëve me diplomë universitare rezultoi shumë e lartë (mesatarisht rreth 45%) në raport me universitetet e tjera (ku kjo përqindje varionte nga 17% në 36%).

Së fundi, shumica e të diplomuarve të mostrës së marrë në studim treguan synimin e tyre për të vazhduar studimet më tej. Kjo nuk ishte për një gjetje t'u habitur, pasi shumica e kampionit përbëhej nga studentët Bachelor. Megjithatë, kjo vlerë është më e ulët në krahasim me vlerën e anketimit të kryer në vitin paraprak.

Në përgjithësi, të dhënat e pyetësorit shërbyen si një mjet i rëndësishëm për të monitoruar kënaqësinë e studentëve, opinionet dhe reagimet e tyre mbi procedurat dhe proceset e brendshme organizative të universitetit, vlerësimet për lehtësirat e ofruara nga universiteti gjatë studimeve të tyre dhe një përmbledhje të synimeve dhe perspektivave të ardhshme të tyre.

Vazhdimësia kohore e një monitorimi të tillë do të mundësojë njohjen e nivelit të cilësisë së institucioneve në lidhje me fusha të ndryshme dhe gjithashtu do të bëjë të mundur vlerësimin e efektit të veprimeve të caktuara që synojnë përmirësimin e pikave të dobta dhe zhvillimin e praktikave të suksesshme në këto institucione. Krahasuar me anketimin e parë, u vu re një përqindje më e madhe e pyetësorëve të vlefshëm; ky përmirësim sugjeron më shumë interes dhe kujdes ndaj synimeve dhe potencialeve të këtij projekti.